

Autorët e spektaklit «Oshëtim e kohës» janë përpjekur t'u bëjnë jehonë në skenën e estradës problemeve të rëndësishme që u trajtuan në Plenumin IV të KQ të Partisë. Me figurat e krijuara në numërat e ndryshëm të spektaklit spektatorit i tërhiqet vëmendja për shfaqje të tilla të huaja në shoqëri si liberalizmi e indiferentizmi, për marrëdhënie të drejta në familje etj., të cilat i japin tingull aktual, që është aq i nevojshëm për një shfaqje estrade.

«Oshëtim e kohës» në Teatrin e Estradës në kryeqytet

Lutlar Vesli

Para spektatorit kalojnë liberali, indiferenti, shpërdorues të pasurisë së popullit, simulantë, qelëpirxhinj, një galeri e tërë tipash dhe karakteresh; ata veprojnë e ndeshen; disa mundohen të rrësqasin, por gjithandej, si një barrikadë e pakapërcyeshme, u del përpara shoqëria, e cila synon t'i bëjë të shëndetshëm në gjirin e saj. Përballë figurave negative jepet edhe shembulli pozitiv, tipa që mishërojnë figurën morale të njeriut tonë, ndërtues të socializmit, të papajtueshëm me të metat dhe gabimet.

Në komedinë «Tënxherja gjeti kapakun», pasqyrimi i shembullit pozitiv jepet më i plotë. Nëpërmjet veprimeve të përgjegjëses së repartit nuk shohim vetëm gruan e emancipuar në sferën e prodhimit, por edhe njeriun tonë, të zgjuar, të shkathët, të vendosur deri në fund për të mbrojtur pronën e përbashkët, duke ia çjerrë maskën elementëve që mundohen të mbulojnë veprimet e tyre nën petkun e «shoqërisë» së sëmurë. Personazhet pozitivë në këtë komedi nuk janë një *deus ex machina* për të zgjidhur situatën, ata veprojnë

duke qenë nxitës dhe organizues të të papriturave, të cilat i vënë personazhet negative në pozitë të disfavorshme; ata, në përpjekje për të mbuluar vetveten, demaskohen akoma më tepër duke u bërë gjithnjë e më të pafuqishëm në sytë tanë. Se-fedini, interpretuar nga Skënder Sallaku, më tepër është viktimë e një rrethi shokësh kafenesh; kundërvënia që ai në fund i bën Raqit, kur kupton fytyrën tij të vërtetë, tregon se rrugët e tyre këtu ndahen, duke e bërë

tetin e Xhemal Myftiut.

Regjizori, duke synuar për ta vendosur punën mbi baza shkencore, ka arritur të zbërthojë natyrën organike të aktorëve; fjala nuk lëshohet diku në përgjithësi, siç kemi parë në ndonjë shfaqje tjetër estrade, por vlerësohet drejt dhe përdoret me saktësi. Megjithatë, ndonëse mjaft skeqe të marra veças tingëllojnë si krijime të plota, me linjë të qartë ndërtimi, me pikën e tyre të rritjes dhe të zgjidhjes, duhet të themi se harmonizimi i tyre rreth një mendimi, që do të ndihmonte për ndërtimin e së tërës, le për të dëshiruar. Spektakli vuan nga një farë horizontalizmi; mungojnë shpërthimet, pikat kulminante të tij, sepse është pikërisht mendimi regjizorial ai që shkrin në një të vetme gjithë komponentët e shfaqjes, skecin, pantomimën etj., dekorin, muzikën, dritat, kostumet, bile ato nuk mund të egzistojnë ndryshe në spektakël veçse si pjesë përbërëse të tij. Prej këtej lind struktura e brendshme dhe e jashtme e shfaqjes, lind stili ose mungesa e interpretimit, prej këtej buron individualiteti krijues i regjizorit.

Në mjaft raste shfaqjet tona të estradës vuajnë pikërisht nga mungesa e një mendimi që të shërbejë si pikënisje dhe bazament i punës së ardhshme. Kjo vjen së në praktikë ndodh që puna për spektaklin të fillojë pa grumbulluar më parë gjithë materialin e nevojshëm mbi të cilin do të lindë edhe mendimi regjizorial. Kështu që edhe pse mund të egzistojë një skicë - ide filletare, duke mos u mishëruar dot artistikisht, shfaqja i ngjan një përzierje të çfardoshme pa lidhje të brendshme organike.

Përkundrazi, skeci, parodia, kupleti, monologu, pantomima, kënga, vallja, numrat akrobatikë, me një fjalë gjithçka që hyjnë në kuptimin e zhanrit, do të zenë në spektakël atë vend që u dikton funksioni për materializimin e idesë. Regjizori me mjetet e tij shprehëse thekson ato materiale që shprehin direkt këtë ide, ato bëhen epigëndra, fillon pra organizimi i shfaqjes; mate-

rialet e tjera më pak të rëndësishme kalojnë në plan të dytë, dhe nëpërmjet një grafiku të tillë shfaqja fiton atë strukturë të brendshme, të qëndrueshme, e cila i ngjan një ndërtese së cilës nuk mund t'i ëvizësh as edhe një gur pa dëmtuar tërësinë.


Në spektaklin «Oshëtim e kohës» mendimi regjizorial, megjithë se egziston, përsëri mbetet i shpërndarë. Kjo ka ardhur në radhë të parë nga zgjedhja e materialit letrar. Qysh këtu fillon materializimi i idesë. Natyrisht, në një shfaqje estrade nuk mund të gjëjë pasqyrim të plotë gjithë gama e problemeve të kohës, por megjithatë ato që janë në rend të ditës duhet pa tjetër të zenë vendin kryesor dhe t'i lepen kani shfaqjes. Do të ishte me vend që spektakli të pasqyronte edhe probleme të tilla thelbësore për të cilat sot preokupohet tërë opinioni ynë shoqëror, lufta për forcimin e shijeve të shëndosha estetike, problemi i kursimit etj.; ka gjithashtu materiale si «Te doktori» dhe «Familja moderne» që ndonëse kapin dhe trajtojnë probleme të qenësishme, nuk i çojnë ato deri në fund. Kështu, ekziston një farë hendeku që rritet më tepër nga trajtimi me një dekor, që në dukje i lehtë e i bukur, mbetet disi i zbrazët e pa funksion. Kemi një qvëshje të ambientit, një dekor të përgjithshëm që i përmbledh të gjitha situatat.

Muzika në këtë spektakël më tepër i ngjan një shtojce, me këngë të interpretuara dobët nga këngëtarë që nuk arrijnë të zbërthejnë përmbajtjen ideo-emocionale. Bën përjashtim këtu këngëtarja Nurie Gjurmaj, e cila me ngrohtësi dhe ndjenjë interpretoi këngën e «Kajo Karafilit».

Shfaqja «Oshëtim e kohës» qëndron me anët e saj më të mira, me materialin më të arrirë aktual e me problematikë të rëndësishme, me konfliktet që vë në qendër, me lojën e shkathët të aktorëve e me një plasikë elegante në ndërtimin e mizanskenave.

Si shfaqje e parë e regjizorit të ri Rifat Pogaj, ajo flet për një punë të kujdeshme me aktorët, premtor për një ngritje të mëtejshme në të ardhmen.

Ekspozitë «Në veprat e pesëvjeçarit»



Në port.

(Viz: N. Vasia)

K. RISILIA

Piktorët duarsakë janë mobilizuar për të pritur 30-vjetorin e qirimit të Atdheut me rezultate sa më të mira në krijimtarinë artistike. Si edhe herë të tjera, kohët e fundit ata kanë vajtur në vepra të rëndësishme të pesëvjeçarit për t'u njohur e frymëzuar nga puna e jeta e klasës punëtore. Me temën e ndërtimit socialist janë edhe punimet e ekspozitës «Në veprat e pesëvjeçarit», të piktorëve G. Priftuli, N. Vasia dhe skulptorit N. Llukaj, që u hap këto ditë në pallatin e kulturës «A. Moisiu» në Durrës. Janë ekspozuar skica me laps, grafika, pas-tele, ku paraqiten momente të ndryshme nga puna në hekurudhën e rinisë Elbasan - Prenjas, në Ballsh; ka edhe punime të kryera në Festivalin folkloristik të vitit 1973 në Gjirokastrë.

Peisazhet e piktorit G. Priftuli, të punuara në pastel, japin një gamë të gjërë të peisazhit industrial me një interpretim artistik brenda një formati të vogël; ato të fusin në madhësinë e vep-rave që po ngre klasa jonë punëtore; zgjidhja koloristike është në unitet me të tërën; këtë e shohim sidomos në peisazhet «Kollonat e koksit», «Ballshi», «Fabrika e be-

tonit», «Ndërtimi i anijeve metalike në kantierin detar» etj.

Piktorin N. Vasia e shohim në një sërë grafikash të punuara në tush dhe në laps. Në disa skica, që janë punuar bukur, paraqitet vrulli revolucionar i rinisë sonë në aksione të ndryshme. Vlejnë të përmenden: «Ura e Bushtricës», «Çaste pune në trase», «Sektori i Bushtricës», «Peisazhi porti».

Skulptori Nelç Llukaj është paraqitur me vizatime të punuara me laps dhe tush kryesisht nga Festivali i fundit folkloristik në Gjirokastrë. Në portretet e festivalistëve janë realizuar mirë artistikisht siçomos punët me laps, si portreti «Vajza nga Kopliku», «Vajza shkodrane» etj.

Ekspozita do të ishte edhe më e pasur po të kishte krijuar me format më të madh, të cilat do të krijojnë larri. Gjithashtu, më tepër vend duhet të zinte njeriu, pavarësisht se punimet janë përshtypje të shpejta nga kantieret.

Megjithatë me freskinë dhe gjallërinë e saj ekspozita dëshmon për punën e mirë të piktorëve dhe ndiqet me interesim nga vizitorët.